

Thirrje për aplikim për dhënien e bursave në kuadër të projektit “Fuqizimi i të rriturve, të rinjve dhe fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes edukimit” i cili financohet nga Danish Refugee Council (DRC) dhe implementohet nga Teach For Kosova

Teach For Kosova hap konkurs për dhënien e bursave për studimet universitare për studentët e komuniteteve **Rom, Ashkali dhe Egjiptian** në Kosovë. Bursat planifikohen të jepen për studentët të cilët në tri vitet e fundit, për shkaqe të ndryshme, i kanë braktisur studimet pas vitit të parë ose të dytë akademik.

Qëllimi i bursave është t'i motivojnë të rinjtë t'i përfundojnë studimet përmes lehtësimit të barrës së shpenzimeve studimore.

Shuma të cilën do ta përfitojnë studentët është **900 Euro** për vit akademik. Nga ky program bursë do të përfitojnë **5 studentë**.

Inkurajohen të aplikojnë studentët të cilëve u kanë mbetur përgjysmë studimet, përkatësisht dy vitet e fundit të studimeve. Dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen në email adresën info@teachforkosova.org.

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- Kopja e Certifikatës së përfundimit të shkollës së mesme (Diploma)
- Dëshmi nga Qendra për Punë Sociale (QPS) ose nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), që studenti ose familja e ngushtë janë përfitues të ndonjërës prej skemave sociale ose që kanë qenë të përfshirë në programet komunale të përkrahjes.
- Kopja e letërnjoftimit.

Afati për dorëzim të aplikimeve është deri më datë **15 Shkurt 2022**, ora 17:00.